

## Programi IPA 2016 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë



---

### MBËSHTETJE PËR SEKTORIN E PESHKIMIT NË SHQIPËRI

Ref. Nr. EuropeAid/155184/DD/ACT/AL

---

### UDHËZIME PËR APLIKIMIN

## SKEMA E GRANTEVE TË INVESTIMEVE NË PESHKIM

**Thirrja e dytë (afati i fundit për dorëzim 05/07/2021 ora 14.00)**



Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian



Projekt i zbatuar nga  
Fondazione Accademia Italiana Marina Mercantile (FAIMM-IMSSEA)

# PËRMBAJTJA

<b>1</b>	<b>Skema e Granteve të «Fishing Blue»</b>	<b>4</b>
1.1	Hyrje	4
1.2	Mbështetja Financiare për Skemën e Granteve të «Fishing Blue»	4
1.3	Përkufizime dhe Akronime	5
<b>2</b>	<b>Sektorët dhe përfituesit e pranueshëm</b>	<b>6</b>
2.1	Kush Mund të Aplikojë	6
2.2	Investimet dhe Aktivitetet e Pranueshme	6
2.3	Akordimi financiar, vlera e mbështetjes dhe kontributi minimal e maksimal	7
2.4	Kohëzgjatja e zbatimit të një projekti investimi	8
<b>3</b>	<b>Aplikimi për mbështetje financiare</b>	<b>8</b>
3.1	Afati i fundit për dorëzimin e Aplikimeve. Periudha e Vlefshmërisë së Thirrjes	8
3.2	Formulari i Aplikimit për Grant	8
3.3	Mënyra e Dorëzimit	8
3.4	Dokumentet që do të dorëzohen	9
3.5	Informacione të tjera	9
<b>4</b>	<b>Pranimi për Financim</b>	<b>10</b>
4.1	Kriteret e Pranimit	10
4.2	Kriteret e Përzgjedhjes	12
<b>5</b>	<b>Dispozita specifike lidhur me pranueshmërinë e investimeve dhe shpenzimeve</b>	<b>13</b>
5.1	Rregullat specifike për dorëzimin e aplikimeve	13
5.2	Investimet dhe Shpenzimet e Pranueshme	13
5.3	Investimet dhe Shpenzimet e Papranueshme	15
5.4	Përshkrimi i pajisjeve të blera	15
<b>6</b>	<b>Procedurat e Vlerësimit dhe Përzgjedhjes, Kontraktimi dhe Zbatimi</b>	<b>16</b>
6.1	Kontrolloni për Përputhshmërinë Administrative dhe Pranueshmërinë	16
6.2	Pranimi i Aplikimit	16
6.3	Përzgjedhja e Aplikimit	17
6.4	Verifikimi në terren	17
6.5	Njoftimi për Aplikantët në lidhje me Vendimin për Akordimin	18
6.6	Shtyrjet e afateve e kohës dhe ndryshimet në kontratë	19
6.7	Pagesa - Miratimi/Ekzekutimi	19
6.8	Kontrollet Ex-Post (përfundimtare)	21
6.9	Ekzekutimi i Pagesave të Grantit	21

<b>6.10 Marrëveshje mbi Vizibilitetin</b>	<b>21</b>
<b>6.11 Bordi i Arbitrazhit</b>	<b>21</b>
<b>7 Lista e Shtojcave</b>	<b>22</b>

---

## 1 Skema e Granteve të «Fishing Blue»

### 1.1 Hyrje

Projekti «Fishing Blue - Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri» i është akorduar *Fondazione Accademia Italiana della Marina Mercantile (FAIMM)*<sup>1</sup> në kuadrin e thirrjes për propozime EuropeAid/155184/DD/ACT/AL shpallur më 27/07/2017. Objektivi global i projektit është të rritë kontributin e sektorit të peshkimit në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë duke përmirësuar menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve të peshkimit në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE-së. Projekti «Fishing Blue» që filloi më 1 nëntor 2018 do të zbatohet për një periudhë prej 42 muajsh.

Përveç mbështetjes për administratën e peshkimit, projekti përfshin hartimin dhe zbatimin e një skeme grantesh për investimet në flotën e peshkimit me qëllim përmirësimin e qëndrueshmërisë së saj, pa rritur sforcën e peshkimit. Skema siguron grante që, së bashku me bashkëfinancimin nga përfituesit, do të synojnë të përmirësojnë elementët që lidhen me lundrimin dhe sigurinë (p.sh. pajisjet radio-satelitore), sigurinë e ushqimit (p.sh. magazinimin e ftohtë), sforcën e peshkimit (p.sh. mjetet e peshkimit) dhe ndotjen e mjedisit (p.sh. motorët). **Buxheti i përgjithshëm** (kontributi i BE-së) i Skemës së Granteve është **750,000 €**. Nëse kjo shumë totale rritet, ajo do të përdoret për financimin e kërkesave të pranueshme që do të rezultojnë nga procesi i përzgjedhjes i përshkruar në këto udhëzime.

Të gjitha aktivitetet do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) të Shqipërisë, e cila do të angazhojë strukturat e saj për të mbështetur aktivitete specifike që lidhen me zbatimin e Skemës së Granteve.

Këto Udhëzime aktuale përcaktojnë rregullat për dorëzimin e aplikimeve, kriteret e pranueshmërisë, vlerësimin, akordimin dhe kontraktimin, verifikimin në terren, zbatimin e investimit, paraqitjen e Kërkesave për Pagesë, kontrollet në vend dhe ekzekutimin e pagesave sipas Skemës së Grantit. Skema do të menaxhohet nga FAIMM që është Autoriteti Kontraktues (AK), përmes një Komiteti Teknik të caktuar posaçërisht dhe stafit të tij.

Këto Udhëzime dhe të gjitha dokumentet që lidhen me Skemën aktuale të Granteve mund të shkarkohen nga faqja e internetit: [www.fishingblue.eu](http://www.fishingblue.eu)

### 1.2 Mbështetja Financiare për Skemën e Granteve të «Fishing Blue»

Objektivi specifik i këtij projekti është mbështetja financiare për: (i) rritjen e sigurisë së peshkatarëve në bordin e anijeve të peshkimit gjatë lundrimit, (ii) përmirësimin e performancës ekonomike të ndërmarrjeve të peshkimit duke adoptuar masa që synojnë kursimin e energjisë dhe përmirësimin e

<sup>1</sup> Partnerë të FAIMM në këtë projekt janë: Ministria e Politikave të Bujqësisë, Ushqimit dhe Pylltarisë (MIPAAF) e Italisë, Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit (bashkë-aplikues dhe i njohur nga Partneri si Pala Specialiste e Projektit dhe Koordinator Teknik); Roja Bregdetare e Italisë (ITCG) (bashkë-aplikues), dhe Instituti i Kërkimeve për Bujqësinë, Peshkimin dhe Ushqimin (ILVO) i Belgjikës (bashkë-aplikues)

magaziminin të ftohtë të prodhimit, dhe (iii) zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis në lidhje me ndotjen e ujit dhe mbrojtjen e rezervës peshkore.

### 1.3 Përkufizime dhe Akronime

- **Afati i dorëzimit:** periudha kohore gjatë të cilës lejohet dorëzimi i aplikimeve.
- **Aktiviteti/veprimi:** përshkrimi i projektit të paraqitur nga Aplikanti për t'u financuar, përfshirë zbërthimin e kostos së investimit dhe grafikun kohor përkatës;
- **Aplikanti:** është një pronar individual, dhe/ose pronarët e kompanive të anijeve të peshkimit, person fizik ose juridik, i cili paraqet një Aplikim për grant;
- **Autoriteti Kontraktues (AK);** *Fondazione Accademia Italiana della Marina Mercantile* - Akademia Italiane e Fondacionit të Marinës Tregtare (FAIMM);
- **Bashkimi Evropian (BE);** donatori që vepron përmes Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, Shqipëri;
- **Bilanci/Regjistri Kontabël;** nëse Aplikanti nuk ka bilanc/regjistër kontabël siç kërkohet dhe lejohet nga legjislacioni shqiptar, ai/ajo duhet ta hartojë vetë një dokument të tillë specific, të dedikuar Skemës aktuale të Granteve, dhe të ruajtur për të paktën 5 vjet pas pagesës së fundit të kryer nga AK;
- **Bordi i Arbitrazhit;** krijuar për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje të mundshme të krijuar mes palëve që nuk zgjidhet në mënyrë miqësore; do të përbëhet nga tre anëtarë, dy prej të cilëve caktohen nga një prej secilës palë dhe i treti me marrëveshje të ndërsjellë mes palëve.
- **Granti;** është një ndihmë financiare e siguruar falas nga BE për të mbështetur sektorin privat të peshkimit; bëhet përmes pagesës nga AK për të rimbursuar një pjesë të shpenzimeve të pranueshme të kryera nga përfituesi për projektin e investimit;
- **Komiteti Teknik (KT);** ai do të menaxhojë gjithë procesin e Skemës së Granteve;
- **Kontributi i Bashkimit Evropian (BE);** është shuma e kontributit financiar të dhënë nga BE në kuadrin e projektit «Fishing Blue» që përbën maksimumi 50% të shpenzimeve totale të pranueshme të projektit të investimit, për një total prej maksimalisht 60,000 EURO;
- **Kontributi i përfituesit;** është vlera e kontributit financiar të dhënë nga përfituesi, e cila mbulon të paktën 50% të shpenzimeve totale të pranueshme të projektit të investimit;
- **MBZHR;** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Shqipërisë (Struktura Administrative e Peshkimit);
- **MIPAAF;** *Ministero delle Politiche Agricole Alimentari e Forestali* - Ministria e Politikave të Bujqësisë, Ushqimit dhe Pylltarisë e Italisë;
- **Përfituesi (ose Përfituesi i Grantit);** është një person fizik ose juridik të cilit i është akorduar një grant për të zbatuar një projekt investimi;
- **Projekti i investimeve;** përbëhet nga një sërë aktiviteteve të investimeve në asete të prekshme që synojnë arritjen e objektivave të sektorit që mbështetet;
- **Shpenzimet e pranueshme;** shpenzimet e aprovuara në përputhje me kërkesat e Skemës së Granteve të përcaktuara në këto Udhëzime;

- **Vendimi për akordimin e grantit dhe nënshkrimi i kontratës;** është një vendim i titullarit autorizues për të akorduar grantin për aplikuesit e suksesshëm bazuar në kontratën e nënshkruar ndërmjet tyre;
- **Vendimi për Autorizimin dhe Ekzekutimin e Grantit;** është një vendim i AK për të autorizuar shumën e grantit dhe ekzekutimin e pagesës;

## 2 **Sektorët dhe përfituesit e pranueshëm**

### 2.1 **Kush Mund të Aplikojë**

Përfituesi i Skemës së Granteve të Investimeve në Peshkim (Programi) është çdo individ ose pronar i kompanive të anijeve të peshkimit të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit në Shqipëri, dhe që zotëron Numrin Unik të Identifikimit (NUI).

Aplikimi pranë Programit mund të paraqitet nga subjektet e mëposhtme:

- pronarët individualë të anijeve të peshkimit, ose
- pronarët e kompanive të anijeve të peshkimit.

Çdo përfitues ka të drejtë të aplikojë për një ose më shumë grante duke respektuar vlerat e paraqitura në seksionin 2.3.

### 2.2 **Investimet dhe Aktivitetet e Pranueshme**

Kategoritë kryesore të shpenzimeve të pranueshme që përputhen me objektivat e skemës së granteve përshkruhen në Tabelën 1 më poshtë.

**Tabela 1 – Lista e Shpenzimeve të Pranueshme**

<b>A. Blerja/modernizimi, dhe instalimi i pajisjeve për ruajtjen dhe trajtimin e prodhimit</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. blerja dhe instalimi i një dhome frigoriferike në bordin e anijeve të peshkimit;</li> <li>2. blerja dhe instalimi i makinave të akullit që do të montohen në bordin e anijeve të peshkimit;</li> <li>3. blerja dhe instalimi i një njësie motorike për kondicionimin e dhomave frigoriferike për ruajtjen e prodhimit;</li> <li>4. blerja dhe instalimi i pajisjeve për të lehtësuar manovrimin e ngarkesave të rënda, përjashtuar makineritë që lidhen drejtpërdrejtë me aktivitetin e peshkimit, siç është vinçi.</li> </ol>
<b>B. Blerja dhe instalimi i pajisjeve elektronike</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. blerja dhe instalimi i pajisjeve satelitore dhe radio-komunikuese (p.sh.: radiot VHF dhe telefonat satelitorë) siç janë radio stacionet GMDSS (VHF, SSB, NATEX, METEOFAX), Fleet Broadband IP (Immarsat B) dhe telefonat satelitorë VHF, madje edhe të llojit portativ;</li> <li>2. blerja dhe instalimi i pajisjeve të lokalizimit satelitor, të tilla si EPIRB, SART (transmetuesi i kërkim-shpëtimit) dhe AIS; radar, GPS, sistemi VMS.</li> </ol>
<b>C. Zëvendësimi i rrjetave ekzistuese me rrjeta më selektive (ekskluzivisht për trata koçet dhe koshilokët)</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. blerja dhe instalimi në bord i rrjetave / trata koçeve; rrjeta e re që zëvendëson të vjetrën duhet të ketë syze me diametër të paktën 40 mm në fundin e saj (fundi i ngushtë i rrjetës në formë</li> </ol>

konike); zëvendësimi i litarëve/kabllove që shoqërojnë përdorimin e rrjetës së re konsiderohet gjithashtu si shpenzim i pranueshëm.

2. blerja dhe instalimi në bord i koshilokëve; rrjeta e re që zëvendëson të vjetrën duhet të ketë syze me diametër jo më pak se 14 mm; zëvendësimi i litarëve, kabllove dhe unazave që shoqërojnë përdorimin e rrjetës së re konsiderohet gjithashtu si shpenzim i pranueshëm.

#### **D. Blerja/modernizimi, dhe instalimi i motorit kryesor dhe atyre ndihmës**

1. blerja dhe instalimi i motorit kryesor dhe atyre ndihmës (në rastin e zëvendësimit të motorit kryesor, fuqia në kW e motorit të ri të instaluar nuk duhet të jetë më e lartë se fuqia e motorit që do të zëvendësohet në anije)
2. blerja e motorit ndihmës (gjeneratorë detarë).

Të gjitha pajisjet që nuk përfshihen në Tabelën 1 më sipër nuk janë të pranueshme për financim.

### **2.3 Akordimi financiar, vlera e mbështetjes dhe kontributi minimal e maksimal**

Shuma totale e vënë në dispozicion në këtë thirrje për propozime është **750,000 €**

Vlera e mbështetjes do të mbulojë maksimumi 50% të **shpenzimeve totale të pranueshme** të Aktivitetit.

Çdo grant i kërkuar duhet të jetë ndërmjet vlerave si më poshtë:

- minimumi: 2,500 €
- maksimumi: 60,000 €

Shpenzimi maksimal i pranueshëm që një përfitues mund të investojë në një anije të vetme është në funksion të Fuqisë Motorike të anijes, e shprehur në kW dhe e llogaritur sipas Tabelës 2 më poshtë.

**Tabela 2 – Shpenzimi maksimal i pranueshëm sipas Fuqisë Motorike (kW)**

<b>Kategoria e anijes sipas klasës së tonazhit (kW)</b>	<b>Shpenzimi maksimal i pranueshëm (€) - SMM për anije individuale</b>
$56 \leq kW < 150$	$SMM = 50 * kW + 7,500$
$150 \leq kW < 300$	$SMM = 300 * kW - 30,000$
$300 \leq kW < 380$	$SMM = 500 * kW - 90,000$
$380 \leq kW < 460$	$SMM = 250 * kW + 5,000$
$460 \leq kW$	$SMM = 120,000$

Nëse fuqia e motorit në kW shprehet nga një numër me presje dhjetore, është rënë dakort që të përafrohet vlera e kW në numrin e plotë pasardhës, për efekt të llogaritjes së shpenzimit maksimal. Shtojca B paraqet vlerën e shpenzimeve maksimale të pranueshme sipas kW.

Nëse shpenzimi i kërkuar i investimeve tejkalon shpenzimin maksimal të pranueshëm të paraqitur në Tabelën 2, aplikuesi duhet të zotërojë plotësisht burime financiare më të mëdha se shpenzimi maksimal i përmendur.

Nëse një aplikues zotëron më shumë se një mjet lundrues, ai/ajo mund të paraqesë nga një aplikim për secilin mjet.

Aplikimi për një mjet lundrues mund të përfshijë një ose më shumë shpenzime të pranueshme të përshkruara në Tabelën 1.

Në çdo rast, shuma totale maksimale e grantit që mund t'i akordohet një përfituesi do të jetë 60,000 € përgjaqtë gjithë periudhës së zbatimit të projektit (Ref. EuropeAid/155184/DD/ACT/AL) e shpërndarë në një ose më shumë anije, duke respektuar shumën maksimale të lejuar për secilën anije, bazuar në Tabelën 2.

#### **2.4 Kohëzgjatja e zbatimit të një projekti investimi**

Periudha e ekzekutimit të kontratës (përfshirë blerje, instalimin dhe pagesën përfundimtare tek përfituesi) do të kryhet brenda 6 muajve nga data e fundit e nënshkrimit të kontratës nga palët, përveç një zgjatjeje të mundshme të referuar në seksionin 6.6.

AK nuk mban përgjegjësi për asnjë vonesë në proces ose për gjobat bankare të aplikuara për përfituesit e granteve, si për shkak të dorëzimit me vonesë të kërkesës për pagesë nga përfituesi i grantit, ashtu dhe miratimit të vonuar të kërkesës së pagesës nga AK.

### **3 Aplikimi për mbështetje financiare**

#### **3.1 Afati i fundit për dorëzimin e Aplikimeve. Periudha e Vlefshmërisë së Thirrjes**

Afati i fundit për dorëzimin e Aplikimeve është 45 ditë pas datës së publikimit në faqen e internetit të projektit, në orën 16:00 (me kohën e Tiranës).

AK nuk mban përgjegjësi për asnjë vonesë.

Çdo aplikim i marrë pas afatit të fundit për dorëzim do të refuzohet.

Nëse një pjesë e fondeve mbetet e disponueshme pas përfundimit të kontratave nga kjo thirrje, do të shpallet një thirrje tjetër, e cila do të publikohet në faqen e internetit të projektit dhe në media.

Të gjitha informacionet që lidhen me këtë thirrje (përfshirë pyetjet dhe përgjigjet siç përcaktohet në seksionin 3.5 më poshtë) do të publikohen në faqen e internetit: [www.fishingblue.eu](http://www.fishingblue.eu).

#### **3.2 Formulari i Aplikimit për Grant**

Aplikimet, së bashku me shtojcat, duhet të plotësohen në një nga gjuhët (shqip ose anglisht) sipas udhëzimeve në Formularin e Aplikimit për Grant (Shtojca A) dhe këto Udhëzime. Aplikantët duhet të përdorin në mënyrë rigoroze formatin e formularit të aplikimit për Grant, të plotësojnë paragrafët dhe faqet sipas radhës, dhe ta nënshkruajnë atë.

Formulari i Aplikimit për Grant duhet të dorëzohet në original.

Propozimet me shkrim dore nuk do të pranohen.

#### **3.3 Mënyra e Dorëzimit**

Aplikimet e plota duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur tek Komiteti Teknik në Tiranë në adresën e mëposhtme:



Projekti i BE «Fishing Blue» - Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri  
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  
Kat i parë  
Zyra nr. 112  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Tiranë - Shqipëri

Aplikimi mund të dërgohet:

- me postë të thjeshtë ose shërbim të shpejtë postar, ose
- dorazi; në këtë rast, zarfi duhet t'i jepet drejtpërdrejtë sekretarisë së Komitetit Teknik, dhe vërtetimi që merret në kohën e dorëzimit të aplikimit do të shërbejë si provë dorëzimi.

Çdo aplikim i dorëzuar me ndonjë mjet tjetër (p.sh. me faks), ose i dorëzuar në adresa të tjera, ose i dorëzuar pas përfundimit të afatit, nuk do të merret në konsideratë. Këto aplikime nuk do të hapen.

Në anën e jashtme të zarfit duhet të shkruhet:

Projekti i BE «Fishing Blue» - Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri  
Ref.: Thirrje për Skemën e Granteve të Investimeve në Peshkim  
TË MOS HAPET PARA FILLIMIT TË SEANCËS SË HAPJES  
(emri dhe adresa e aplikuesit)

### **3.4 Dokumentet që do të dorëzohen**

Zarfi duhet të përmbajë:

- i. Formularin e Aplikimit për Grant të plotësuar sipas modelit të dhënë në Shtojcën A,
- ii. kopjen e licencës së veprimtarisë së peshkimit,
- iii. kopjen e dokumentit të regjistrimit të biznesit,
- iv. oferta të krahasueshme të dhëna për investimin e propozuar, nga të paktën tre furnitorë, përfshirë broshurat mbështetëse, dhe
- v. Deklaratën e Nderit, të nënshkruar (Shtojca C) që aplikuesi nuk gjendet në asnjë nga situatat e përshkruara në Tabelën 3 më poshtë.

Të gjithë dokumentet e sipërpërmendura do të duhet të dorëzohen edhe në format digjital (CD).

### **3.5 Informacione të tjera**

Pyetjet mund të dërgohen me shkrim me e-mail jo më vonë se 21 ditë para afatit të fundit për dorëzimin e Aplikimeve në adresën e shënuar më poshtë, duke paraqitur qartë referencën për «Skemën e Granteve të Investimeve në Peshkim».

Adresa e e-mail-it: [grantscheme@fishingblue.eu](mailto:grantscheme@fishingblue.eu).

Përgjigjet do të jepen vetëm me shkrim përmes faqes së internetit të thirrjes për grante, jo më vonë se 11 ditë para afatit të fundit për dorëzimin e Aplikimeve.

## 4 Pranimi për Financim

### 4.1 Kriteret e Pranimit

Thirrja për pjesëmarrje në Skema e Granteve të Investimeve në Peshkim është e hapur për individët dhe/ose pronarët e kompanive të anijeve të peshkimit, të cilët plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) anija e peshkimit, duhet të jetë e regjistruar në regjistrin e flotës së Shqipërisë,
- b) të jetë shtetas shqiptar, nëse aplikuesi është pronar individ,
- c) të jetë i regjistruar në Shqipëri, nëse aplikuesi është një kompani pronare e anijeve,
- d) të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nëse aplikuesi është kompani,
- e) anija e peshkimit, që aplikon për të marrë mbështetje financiare, duhet të ketë një licencë të vlefshme peshkimi që mundëson kryerjen e veprimtarisë së peshkimit profesional,
- f) anija e peshkimit duhet të ketë kryer veprimtarinë e peshkimit në det për të paktën 60 ditë gjatë dy viteve të fundit nga data e thirrjes dhe kjo vërtetohet ose me regjistrin (logbook) ose me një letër zyrtare të Inspektorit të Peshkimit të portit ku anija kryen veprimtarinë, apo dokumente të tjerë mbështetës,
- g) përjashtim nga pika e mësipërme f) bëjnë ato anije peshkimi që janë përputhje me Kreun 30, pika 9, të Ligjit nr. 42/2020, datë 23.04.2020 "Për disa ndryshime në Ligjin 64/2012 "Për Peshkimin"; këto janë anije që, edhe pse janë të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit dhe që mbajnë numrin unik të identifikimit (NUI), nuk kanë mundur të plotësojnë kërkesën për aktivitetin minimal të peshkimit në det (dmth 60 ditë gjatë dy viteve të fundit), për shkak të rasteve të jashtëzakonshme, të tilla si kanë qenë duke u riparuar, por kanë të drejtë të aplikojnë për rinovimin e licencës së peshkimit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve,
- h) anija e peshkimit duhet të ketë një gjatësi të përgjithshme, në metra, më të madhe ose të barabartë me 10 metra dhe me një fuqi motorike më të madhe ose të barabartë me 56 kW.

Një operator ekonomik do të përjashtohet nga pjesëmarrja në Skemën e Granteve "Fishing Blue" nëse gjendet në njërin nga situatat e parashikuara në kapitullin 2.6.10.1.1 të Udhëzuesit Praktik të BE-së për procedurat e kontratës (PRAG)<sup>2</sup> duke iu referuar kritereve të përjashtimit nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe granteve, të cilat (kruteret), për efekt lehtësie janë cituar përsëri në Tabelën 3 më poshtë.

<sup>2</sup> Për më shumë hollësi, shih: <https://ec.europa.eu/europeaid/prag/document.do?nodeNumber=2.6.10.1.1>

**Tabela 3 – Kriteret e Përjashtimit nga Pjesëmarrja në Procedurat e Prokurimit dhe Granteve të BE-së**

<ul style="list-style-type: none"> <li>• a) ka falimentuar, është subjekt i falimentimit ose procedurave të mbylljes, kur pasuritë e tij administrohen nga një likuidues ose nga një gjykatë, kur është në një marrëveshje me kreditorët, kur aktivitetet e tij të biznesit janë pezulluar, ose kur është në ndonjë situatë analoge që rrjedh nga një procedurë e ngjashme e parashikuar nga ligjet ose rregulloret kombëtare;</li> <li>• b) është vërtetuar nga një gjykim i formës së prerë ose një vendim administrativ i formës së prerë që operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagimin e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore në përputhje me ligjet në fuqi;</li> <li>• c) është vërtetuar nga një gjykim i formës së prerë ose një vendim administrativ i formës së prerë që operatori ekonomik është fajtor për sjellje të rëndë profesionale duke shkelur ligjet ose rregulloret e zbatueshme ose standardet etike të profesionit të cilit operatori ekonomik i përket, ose duke u përfshirë në sjellje të gabuara që ndikojnë në besueshmërinë e tij profesionale kur një sjellje e tillë dëshmon një qëllim të gabuar ose neglizhencë të rëndë, duke përfshirë, në veçanti, sa vijon: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) paraqitja e gabuar, me qëllim mashtrimi ose neglizhencë, e informacionit të kërkuar për verifikimin e mungesës së arsyeve të përjashtimit, ose përmbushjes së kriterëve të përzgjedhjes, ose për ekzekutimin e një kontrate;</li> <li>ii) hyrja në marrëveshje me operatorët e tjerë ekonomikë me qëllim eliminimin e konkurrencës;</li> <li>iii) shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale;;</li> <li>iv) përpjekja për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktues gjatë procedurës së prokurimit;</li> <li>v) përpjekja për të marrë informacione konfidenciale që mund t'i japin atij përparësi të padrejta në procedurën e prokurimit;</li> </ul> </li> <li>• d) është vërtetuar me vendim të formës së prerë që operatori ekonomik është fajtor për një nga rastet si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) mashtrim, sipas kuptimit të Nenit 3 të Direktivës (BE) 2017/1371 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 korrik 2017 për luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiare të Bashkimit përmes mjeteve të ligjit penal dhe nenit 1 të Konventës për mbrojtjen e interesave financiare të KE-së të hartuar nga Akti i Këshillit i 26 korrikut 1995;</li> <li>ii) korrupsion, siç parashikohet në Nenin 4(2) të Direktivës (BE) 2017/1371 dhe Nenit 3 të Konventës për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarë të Komunitetit Evropian ose zyrtarë të Shteteve Anëtare të BE-së, të hartuar nga Akti i Këshillit të 26 majit 1997, dhe në Nenin 2(1) të Vendimit Kuadër të Këshillit 2003/568/JHA të 22 korrikut 2003 për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat, si dhe korrupsioni siç parashikohet në ligjin e shtetit ku është vendosur autoriteti kontraktues, shtetit në të cilin është vendosur operatori ekonomik ose shtetit ky kryhet ekzekutimi i kontratës;</li> <li>iii) sjellje që lidhet me një organizatë kriminale referuar në Nenin 2 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/841/JHA të 24 tetorit 2008 për luftën kundër krimit të organizuar;</li> <li>iv) pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit sipas kuptimit të Neneve 1(3), (4) dhe (5) të Direktivës (BE) 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, date 20 maj 2015, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllimet e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që amendon Rregulloren (BE) Nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizon Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/EC (Teksti me rëndësi për ZEE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;</li> <li>v) vepra të lidhura me terrorizmin ose vepra të lidhura me aktivitete terroriste, siç parashikohet në Nenet 1 dhe 3 të Vendimit Kuadër të Këshillit të 13 qershorit 2002 për luftën kundër terrorizmit, apo nxitjen, ndihmën ose shtysën për të kryer vepra të tilla, siç referohet në Nenin 4 të Vendimit Kuadër;</li> <li>vi) shfrytëzimi i punës së të miturve ose forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore siç parashikohet në Nenin 2 të Direktivës 2011/36/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 5 prillit 2011 për parandalimin dhe</li> </ul> </li> </ul>
--

luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave prej tij, dhe Vendimi Kuadër 2002/629/JHA;

- e) operatori ekonomik ka treguar mangësi të konsiderueshme në përmbushjen e detyrimeve kryesore në realizimin e një kontrate të financuar nga BE, gjë që ka çuar në përfundimin e parakohshëm të një angazhimi ligjor, në aplikimin e likuidimit të dëmeve, në dënime të tjera kontraktuale, ose që është zbuluar pas auditeve dhe/ose hetimeve të kryera nga një zyrtar i autorizuar, nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) ose nga Gjykata e Audituesve;
- f) është vërtetuar me vendim të formës së prerë ose vendim administrativ të formës së prerë që operatori ekonomik ka kryer një parregullsi sipas kuptimit të Nenit 1(2) të Rregullores së Këshillit (KE, Euratom) Nr. 2988/95 e datës 18 dhjetor 1995 për mbrojtjen e interesave financiare të Komunitetit Evropian.
- g) është vërtetuar me vendim të formës së prerë ose vendim administrativ të formës së prerë që personi ose entiteti ka krijuar një njësi ekonomike nën një juridiksion tjetër me synimin për të anashkaluar detyrimet fiskale, detyrimet sociale ose ndonjë detyrim tjetër ligjor të detyrueshëm për zbatim nën juridiksionin e vendit ku ka regjistruar zyrën, ka administratën qendrore ose vendit ku kryen pjesën kryesore të biznesit.
- h) është vërtetuar me vendim të formës së prerë ose vendim administrativ të formës së prerë që një entitet është krijuar me qëllimin e parashikuar në pikën (g).

Autoriteti kontraktues duhet të përjashtojë një operator ekonomik në rastet kur:

- një person fizik ose juridik, i cili është anëtar i organit administrativ, menaxhues ose mbikëqyrës, ose ka fuqinë e përfaqësimit, vendimit ose kontrollit mbi operatorin ekonomik, është në një situatë të referuar në pikat c) deri h);
- një person fizik ose juridik që merr përgjegjësi të pakufizuar për borxhet e këtij operatori ekonomik është në një situatë të referuar në pikat a) ose b);
- një person fizik ose juridik i cili është kyç për akordimin ose për zbatimin e angazhimit ligjor dhe është në një situatë të referuar në pikat c) deri h).

#### 4.2 Kriteret e Përzgjedhjes

Aplikimet që plotësojnë kërkesat e përmendura në paragrafët e mëparshëm janë subjekt i përzgjedhjes, që kryhet duke llogaritur rezultatin përkatës, të rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore, bazuar në kriteret e përcaktuara në Tabelën 4 më poshtë.

Tabela 4 – Kriteret e Përzgjedhjes

Nr.	Përshkrimi i kriterit	Vlera	Koeficienti C (0<C<1)	Pesha (Ps)	Rezultati P=C*Ps
1	Mosha e pronarit të anijes (individ) ose e përfaqësuesit ligjor (kompani) (Et)	Et≤40	C=1	5	
		40<Et≤50	C=0,75		
		50<Et≤60	C=0.5		
		Et>60	C=0		
2	Aktiviteti përfshin zëvendësimin e motorit kryesor (Mp)	Mp=No	C=0	20	
		Mp=Yes	C=1		
3	Aktiviteti përfshin instalimin e dhomave frigoriferike të pajisura me motor kondicionimi (CF)	Cf=No	C=0	10	
		Cf=Yes	C=1		
4		nt=No	C=0	5	

	Aktiviteti përfshin zëvendësimin e rrjetave të trata koçeve ose koshilokëve (nt)	nt=Yes	C=1		
5	Aktiviteti përfshin blerjen dhe/ose zëvendësimin e pajisjeve elektronike (Oe)	Oe=No	C=0	5	
		Oe=Yes	C=1		
6	Tonazhi i anijes i pjesëtuar me tonazhin maksimal aktual në regjistrin e flotës, i barabartë me 371 (VI)	$VI=nGT/371$	C=VI	5	
7	Numri i kW të motorit në raport me kW të motorit më të madh të pranishëm në flotë (2,282) (Val)	$Val=nkW/2282$	C=Val	20	
8	Mosha e anijes në vite (An)	$An>40$	C=0	30	
		$30<An\leq 40$	C=0,25		
		$20<An\leq 30$	C=0,5		
		$10<An\leq 20$	C=0,75		
		$0<An\leq 10$	C=1		
<b>TOTAL=</b>				<b>100</b>	

Rezultati (P) që del nga secili prej parametrave të adoptuar dhe që i atribuohen aktivitetëve, do të jetë i barabartë me prodhimin mes «peshës» (Ps) të secilit parametër, që është një vlerë mes 0 dhe 100, dhe koeficientëve (C) vlera e të cilëve, që është ndërmjet 0 dhe 1, shpreh praninë/mungesën e një kërkesë specifike ose shkallën e plotësimit të kënaqshëm të parametrit; vlera e koeficientit (C) duhet të rumbullakoset deri në dy shifra pas presjes dhjetore. E njëjta rumbullakosje do të bëhet për rezultatin (P). Shuma e të gjitha peshave që i atribuohen kriterëve të përzgjedhjes duhet të jetë e barabartë me 100, në mënyrë që të mundësohet renditja deri në të qindtat (dy shifra pas presjes).

Në rast barazimi do të mbizotërojë projekti me koston totale më të lartë të investimit dhe, në rast se edhe këtu do të ketë barazim, atëherë do t'i jepet përparësi aplikimit të dorëzuar më herët.

## 5 Dispozita specifike lidhur me pranueshmërinë e investimeve dhe shpenzimeve

### 5.1 Rregullat specifike për dorëzimin e aplikimeve

Në seksionet vijues, përshkruhen rregullat specifike për dorëzimin e aplikimeve.

### 5.2 Investimet dhe Shpenzimet e Pranueshme

Vetëm kostot e pranueshme mund të konsiderohen pjesë e Programit.

Prandaj, si kostot e financuara nga Programi ashtu dhe ato të bashkë-financuara nga Aplikanti duhet të jenë kosto të pranueshme. Një kosto është e pranueshme nëse plotëson të gjitha kriteret e mëposhtme:

- kostoja kërkohet për zbatimin e Aktivitetit, identifikohet në listën e investimeve të pranueshme (shih seksionin 2.2), përshkruhet në formularin e aplikimit dhe përputhet me zberthimin e kostos, që është dorëzuar si pjesë e aplikimit. Kështu që, kostot e shprehura si shuma fikse (lump sum) nuk janë të pranueshme;
- kostoja është e identifikueshme dhe e verifikueshme, është e arsyeshme, e justifikuar dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit të shëndoshë financiar;
- kostoja/shpenzimet kryhen të gjitha vetëm nga aplikuesi;
- kostot do të mbulojnë vlerën e blerjes së mallrave të përshkruar në Tabelën 1 dhe çdo shërbim ose punë që lidhet me zëvendësimin, instalimin dhe testimin e tyre. Kostot e asgjësimit të pajisjeve të zëvendësuara ose të mbetjeve që rezultojnë nga operacionet e instalimit, nuk do të konsiderohen të pranueshme;
- çdo shpenzim duhet të dokumentohet nga faturat e lëshuara nga furnizuesit e regjistruar ose ofruesit e shërbimeve, siç kërkohet nga legjislacioni shqiptar, si dhe nga prova përkatëse e kryerjes së pagesës (nuk lejohen pagesa me lekë në dorë) siç detajohet më poshtë:
  - o për ndërmarrjet: faturat duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël të Përfituesit të Grantit ose pronarit të anijes dhe të evidentohen në përputhje me standardet e zbatueshme të kontabilitetit në Republikën e Shqipërisë,
  - o për personat fizikë, faturat duhet t'i drejtohen personit fizik dhe të regjistrohen në një dosje të posaçme të krijuar dhe mbajtur nga përfituesi,dëftesat nuk lejohen si dokumentacion mbështetës i shpenzimeve;
- shpenzimet kryhen dhe disbursohen gjatë periudhës së zbatimit të Aktivitetit, siç parashikohet në seksionin paraardhës 2.5; prandaj, investimet nuk mund të fillojnë para datës së nënshkrimit të kontratës me AK; çdo shpenzim i kërkuar në aplikim që është kryer, ose ka nisur të zbatohet para se të përfundojë verifikimi paraprak (*ex-ante*) në terren, do të konsiderohet i papranueshëm;
- të gjitha pagesat e kostove të pranueshme duhet të bëhen me transfertë bankare nga llogaria e përfituesit të grantit ose pronarit të anijes në llogarinë e furnizuesit dhe kjo duhet të vërtetohet nga deklaratat bankare për datën kur është bërë transferimi; nuk do të lejohet asnjë pagesë me para në dorë (cash).

Në procesin e verifikimit të kostove, Komiteti Teknik mund të kërkojë sqarime, të miratojë ulje të buxhetit ose të deklarojë shpenzime të papranueshme, në përputhje me dokumentacionin që i është vënë në dispozicion.

Nëse Komiteti Teknik mendon se kostot e paraqitura nga aplikuesi në aplikimin e tij janë shumë më të larta se ato që paguhen zakonisht në treg, Komiteti Teknik mund të kërkojë sqarime përpara se të vendosë nëse do ta pranojë plotësisht aplikimin, do të zbresë kostot e pajustificuara ose do të refuzojë aplikimin në tërësi. Prandaj, është në interesin e Aplikantit që të paraqesë një buxhet realist dhe të detajuar me të gjitha arsyetimet, për të lehtësuar procesin e verifikimit.

### **5.3 Investimet dhe Shpenzimet e Papranueshme**

Investimet/shpenzimet e mëposhtme janë të papranueshme:

- blerja e makinerive/pajisjeve të paparashikuara në listën e investimeve të pranueshme (shih Tabelën 1 më sipër),
- blerja dhe instalimi i makinerive të prodhimit, nëse nuk synojnë qartë dhe drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të projektit,
- blerja e makinerive/pajisjeve të përdorura ose të riparuar,
- kostot për riparimet dhe mirëmbajtjen rutinë,
- kostot që lidhen me kërkesat dhe procedimin e kredisë,
- materialet e konsumit që lidhen me aktivitetet e zakonshme të përfituesit dhe për të cilat nuk është provuar lidhja me aktivitetet e financuara nga granti,
- mirëmbajtja rutinë e makinerive/pajisjeve,
- puna e aplikantit, punonjësve ose të afërmeve të tij në kuadrin e grantit për investim,
- çdo kontribut në natyrë,
- shpenzimet e bëra para nënshkrimit të kontratës së Grantit,
- pagesat e interesave, tarifave bankare, kostot e garancive, detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo tarifë tjetër, dhe
- pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), ose tatimeve të tjera.

### **5.4 Përshkrimi i pajisjeve të blera**

Aplikuesit i kërkohet të paraqesë dokumentacionin e plotë në lidhje me blerjen e pajisjeve, punimet për ndërtimin e dhomave frigoriferike dhe për instalimin e pajisjeve (nëse është rasti), siç ilustruhet më poshtë.

Pajisjet duhet të jenë të reja, të papërdorura, të certifikuara CE dhe të kenë një garanci nga furnizuesi për të paktën një (1) vit.

Për blerjen e pajisjeve, ndërtimin e dhomave frigoriferike dhe punimet përkatëse të instalimit, aplikuesi kërkohet të paraqesë të paktën 3 (tre) kosto të vlerësuara (oferta) për pajisjet dhe/ose instalimin, dhe/ose zbatimin e ndërhyrjeve të paraqitura në Tabelën 1, gërma A, të siguruara nga po kaq kompani.

Çdo ofertë duhet të përmbajë:

- numrin dhe datën e lëshimit;
- emrin e kompanisë;
- emrin e kompanisë së aplikuesit, kodin tatimor, numrin e regjistrimit;
- një përshkrim të hollësishëm të pajisjeve ose furnizimeve (p.sh. përmasat, konsumi i energjisë, fuqia, karakteristikat kryesore, etj.) ose i punës që do të kryhet (dhomat frigoriferike);
- përshkrimi i punimeve që do të kryhen për instalimi;
- çmimi i tatueshëm i mallrave ose punimeve, përqindja e TVSH-së së cilës i nënshtrohet çmimi, vlera e TVSH-së dhe shuma totale;
- informacione të tjera të dobishme në lidhje me çertifikimin, garancinë, kohën e dorëzimit të pajisjeve dhe çmimin përfundimtar në destinacion.



Vlerësimi i shumës së kërkuar për financim do të bazohet në një tabelë të detajuar të zërthimit të kostos, ku çmimi i blerjes së pajisjeve të përshkruara në Tabelën 1 tregohet veçmas nga çmimi i shërbimeve, instalimit ose ndonjë aktiviteti tjetër ndihmës në lidhje me investimin.

Çdo ofertë duhet të shoqërohet nga broshura ose materiale të tjera që demonstrojnë përputhjen me parametrat teknikë ose specifikimet e pajisjeve të kërkuara, që do të sigurohen nga furnizuesi për aplikuesin. Është në të drejtën e aplikuesit që të propozojë, në përputhje me kërkesat e paraqitura në këto Udhëzime, opsionin më të mirë të investimit duke marrë parasysh parametrat tekniko-ekonomikë të pajisjeve dhe çmimet e tregut.

Komiteti Teknik rezervon të drejtën për të vlerësuar se sa të drejta janë çmimet e pajisjeve dhe punëve të parashikuara në projekt.

## **6 Procedurat e Vlerësimit dhe Përzgjedhjes, Kontraktimi dhe Zbatimi**

Të gjitha aplikimet e paraqitura do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve të mëposhtme.

### **6.1 Kontrolloni për Përputhshmërinë Administrative dhe Pranueshmërinë**

Të gjitha aplikimet e marra brenda afatit të dorëzimit dhe në përputhje me kërkesat e përshkruara në seksionin 3.3, do të numërtohen dhe do të hapen për vlerësim. Megjithatë, rezultatet përfundimtare do të përcaktohen dhe do të publikohen pasi të jetë kryer e gjithë procedura për të gjitha aplikimet.

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komiteti Teknik i përbërë nga pesë persona.

Më tej, do të kryhen kontrollet «në vend» dhe kontrollet «ex-post» për anijet e përfshira në një aplikim (shih përkatësisht seksionet 6.6 dhe 6.9 më poshtë). Këto kontrolle do të kryhen drejtpërdrejt nga një zyrtar teknik i emëruar nga AK i ndihmuar nga inspektori i portit pas njoftimit për përfituesin e grantit. Një raport specifik do t'i dërgohet Komitetit Teknik.

Vlerësimi i Aplikimeve do të kryhet sipas hapave të mëposhtëm:

### **6.2 Pranimi i Aplikimit**

Aplikimi i dorëzuar regjistrohet me emrin e aplikuesit, datën dhe orën dhe i vendoset numri përkatës.

Aplikimi nuk do të pranohet nëse:

- është dërguar me mënyra nga ato të kërkuara, ose i është dërguar një entiteti tjetër të ndryshëm nga AK siç parashikohet në seksionin 3.3,
- është marrë pas afatit të fundit të dorëzimit të aplikimit, dhe
- në rast të dorëzimit me postë ose dorazi, paketa është e hapur ose e dëmtuar.

Të gjitha aplikimet e dorëzuar me postë/dorazi do të regjistrohen nga AK pasi të jenë nënshkruar nga personi që kryen dorëzimin. Më pas, të gjitha aplikimet që do të vërehet se i përkasin njëres prej situatave të mësipërme të mospranimit, nuk do të hapen.

Me përjashtim të rasteve të mësipërme, aplikimi pranohet kalon në hapin tjetër që është kontrolli i pranueshmërisë.

Hapi i dytë do të kontrollojë nëse aplikimi është i plotë dhe përmban të gjitha dokumentet e kërkuara.



Aplikimi do të refuzohet nëse do të vërehet një nga rastet e mëposhtme:

- formulari i aplikimit mungon, ose nuk është paraqitur sipas modelit të dhënë (Shtojca A),
- formulari i aplikimit është shkruar me dorë,
- formulari i aplikimit nuk është i nënshkruar,
- një ose më shumë dokumente mbështetës mungojnë,
- një ose më shumë formularë ose dokumente teknike mungojnë ose janë të shkruar me dorë, ose
- i njëjti aplikues ka paraqitur dy aplikime për të njëjtën anije gjatë së njëjtës thirrje për aplikime.

Në rast se aplikimi përmban gabime të vogla ose ka mungesa në informacione, të tilla si:

- aplikimi përmban gabime ose mungesa në tekst duke e bërë të paqartë ose të vështirë për t'u kuptuar, ose
- kërkesat për dorëzim, të përshkruara në seksionin 3.4 nuk janë respektuar në mënyrë korrekte.

Komiteti Teknik mund të vendosë të mos e refuzojë aplikimin, por të kërkojë sqarime.

Aplikanti duhet të paraqesë brenda 5 ditëve sqarimet e kërkuara nga Komiteti Teknik. Pas këtij afati, në mungesë të sqarimeve, aplikimi do të konsiderohet i papranueshëm.

Për aplikimet që kalojnë hapin e dytë, do të vlerësohen kriteret e pranueshmërisë të përmendura në seksionin 4.1.

### **6.3 Përzgjedhja e Aplikimit**

Në këtë fazë, do të kryhet nxjerrja e rezultateve.

Përzgjedhja e aplikimeve do të bazohet në rezultatin mbi dobinë dhe efektivitetin e investimit, siç paraqitet në Tabelën 4.

Sa i takon përshkrimin të investimit, aplikuesi duhet të paraqesë informacion të detajuar për:

- anijen (numri i ditëve në det gjatë dy viteve të fundit, lloji i peshkimit),
- të dhëna mbi personelin (numri i muajve që peshkatarët kane qenë në bord gjatë dy viteve të fundit), dhe
- Lloji i investimit referuar Tabelës 1 (p.sh. A.1) të këtyre Udhëzimeve, duke shpjeguar arsyen pse ai po e kryen këtë investim (ka vlerë paraqitja e fotografive që demonstrojnë gjendjen aktuale të pajisjeve që do të zëvendësohen).

Në rast të informacionit jo të plotë, të paqartë ose të pasaktë, Komiteti Teknik mund t'i kërkojë aplikuesit të japë sqarime. Aplikanti duhet të përgjigjet me e-mail, normalisht brenda 48 orësh pas marrjes së njoftimit nga Komiteti Teknik. Nëse nuk jepet asnjë përgjigje ose përgjigja është plotësisht e pakënaqshme, aplikimi do të refuzohet. Përndryshe, ai do të marrë një rezultat më të ulët.

### **6.4 Verifikimi në terren**

Para se të vendosë për të akorduar një kontratë, AK do të kryejë verifikimin në terren të përshtatshmërisë së aplikimit në mënyrë që të verifikojë nëse dokumentacioni i paraqitur si pjesë e

aplikimit korrespondon me realitetin. Një verifikim i tillë do të kryhet nga personeli i AK i ndihmuar nga inspektori i portit.

Aplikanti do të njoftohet paraprakisht për verifikimin në terren. Ai duhet të jetë i pranishëm në misionin e verifikimit dhe të lehtësojë aksesin në dokumentet origjinale dhe anijen(et).

Pas verifikimit në terren, Komiteti Teknik mund të:

- refuzojë aplikimin nëse verifikimi zbulon se ka mospërputhje midis informacionit të dhënë në aplikim dhe vlerësimit në terren, ose
- miratojë kërkesën për financim.

### **6.5 Njoftimi për Aplikantët në lidhje me Vendimin për Akordimin**

Pas verifikimeve në terren, numri i kontratave që do të financohen nga skema e granteve të investimeve do të përcaktohet dhe renditet sipas rezultatit të vlerësimit. Këto kontrata do të miratohen nga MBZHR.

Çdo aplikim i pranueshëm që nuk mund të financohet nga buxheti i disponueshëm i skemës së investimeve, do të mbetet në listën e pritjes për t'u financuar nëse ndonjë nga aplikuesit fitues vendos të tërhiqet, apo nëse investimi nuk do të disbursohet plotësisht, ose do të vihen në dispozicion fonde shtesë nga burime të tjera.

Aplikuesit do të informohen me shkrim për vendimin e AK në lidhje me aplikimin e tyre. Nëse aplikuesi beson se vendimi është ndikuar nga një gjykim i pasaktë, një gabim ose parregullsi gjatë procesit të vlerësimit, ai mund të dërgojë në AK, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit, një ankesë kundër vendimit të marrë. AK do të përgjigjet zyrtarisht brenda 10 ditëve të punës. Kjo përgjigje do të jetë përfundimtare mbi procedurë dhe e paapelueshme (e formës së prerë)..

Aplikantët e suksesshëm do të marrin një Njoftim për Akordimin e Grantit, përmes të cilit përfituesi do të ftohet të nënshkruajë Kontratën. Pas këtij njoftimi, kontrata do të nënshkruhet në zyrën e AK-së.

Përfaqësuesi i përfituesit, i cili do të nënshkruajë kontratën do të jetë ai që ka nënshkruar formularin e aplikimit. Në rast se personi nuk mund të jetë i pranishëm për nënshkrim, një person i autorizuar do të delegohet për ta nënshkruar kontratën.

Kontrata e Grantit do të miratohet nga MBZHR, dhe hartohet në tre kopje, një për AK dhe një tjetër për përfituesin e Grantit , ndërkohë që do të caktohet një numër reference për komunikimet në vijim.

Rezultatet e vlerësimit dhe përzgjedhjes së Aplikimeve do të publikohen në faqen e internetit: [www.fishingblue.eu](http://www.fishingblue.eu).

Përfituesi i Grantit është i detyruar të zbatojë grantin jo më vonë se data e përcaktuar në kontratë. Përfituesi i grantit është përgjegjës për mbajtjen e të gjithë dokumentacionit në lidhje me pagesat e investimeve për 5 vitet e ardhshme pas pagesës së fundit të kryer nga AK-ja. AK-ja do të mbajë për të njëjtën periudhë kopje të të gjithë dokumentacionit të lëshuar.

## **6.6 Shtyrjet e afateve dhe ndryshimet në kontratë**

Koha për kryerjen e investimit, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës deri në pagesën përfundimtare, normalisht nuk është më e gjatë se 6 muaj.

Përfituesit i kërkohet të kryejë investimin(et) dhe të dorëzojë kërkesën për pagesë brenda afatit kohor të parashikuar në kontratë.

Kërkesa për shtyrjen e afatit duhet të paraqitet tek AK brenda 30 ditëve para përfundimit të periudhës së zbatimit të investimit siç parashikohet në kontratën përkatëse, së bashku me arsyet për të cilat kërkohet kjo shtyrje.

AK mund të refuzojë kërkesën duke kërkuar më shumë sqarime, ose të pranojë shtyrjen e afatit përmes një ndryshimi në kontratë, brenda 30 ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga Përfituesi.

Si rregull, shtyrja e afatit do të bëhet për një periudhë jo më të gjatë se periudha fillestare e zbatimit, e parashikuar në kontratë.

Asnjë shtyrje afati nuk mund të jepet pas datës 31 dhjetor 2021. Në rast se kjo datë shtyhet, do të bëhet njoftimi përkatës në faqen e internetit të projektit.

Ndryshimet gjatë zbatimit të kontratës lejohen, me kusht që funksionaliteti i përgjithshëm dhe qëllimet fillestare të aktivitetit të mbeten të pandryshuara, dhe që ndryshimet të jenë në përputhje me këto qëllime.

Këto ndryshime duhet të kenë parasysh vetëm pajisjet dhe shërbimet përkatëse, referuar në seksionet A, B, C dhe D të Tabelës 1, të cilat janë përfshirë në kontratë. Kërkesa, e mbështetur nga një arsyetim i qartë dhe dokumentacion i plotë Teknik, duhet të paraqitet të paktën 30 ditë para përfundimit të periudhës së zbatimit të investimit.

Ndryshime të tilla mund të përfshijnë shtesa, heqje, zëvendësime, ndryshime të cilësisë, sasisë, formës, karakterit, llojit, si dhe shërbimet përkatëse dhe punët e nevojshme për instalimin e pajisjeve. Në asnjë rast, ndryshimet e propozuara nuk do të rritin çmimin e kontratës.

Pas marrjes së kërkesës së përfituesit për një ndryshim të kontratës, AK do të vendosë pa vonesë nëse do të pranojë ose jo ndryshimet. Ndryshimet që sjellin ulje të vlerësimit të aplikimit dhe si pasojë edhe të rezultatit të renditjes, nuk mund të pranohen; ose në rast të rrethanave të justifikuara posaçërisht dhe përtej fuqisë së përfituesit (të tilla si forcat madhore), mund të aplikohet një ulje në çmimin e kontratës.

Ndryshimet e kontratës duhet të zyrtarizohen përmes një amendimi të kontratës i nënshkruar nga të dy palët para datës së përfundimit të periudhës së zbatimit të kontratës.

## **6.7 Pagesa - Miratimi/Ekzekutimi**

Pagesa e kontributit të BE-së për përfituesit do të disbursohet sipas njërës prej opsioneve të mëposhtme pas verifikimit në vend të investimit nga ana e AK-së.

Opsioni 1: vetëm një pagesë përfundimtare pas përfundimit të të gjithë investimit sipas kontratës;

Opsioni 2:

1. 40% të çmimit të përgjithshëm të kontratës pas nënshkrimit të kontratës, kundrejt dorëzimit të një garancie paradhënieje për shumën e plotë të pagesës së paradhënies;
2. 60% të çmimit të përgjithshëm të kontratës, pagesa e pjesës së mbetur, pas marrjes nga autoriteti kontraktues të kërkesës për pagesë.

Opsioni 3, pagesa të shumëfishta: një pagesë pas përfundimit të çdo aktivitetit/ndërrhyrjeje të listuar në tabelën «Lista e Shpenzimeve të Pranueshme» dhe të identifikuar me shkronjat A, B, C dhe D. Ky opsion mund të aplikohet vetëm nëse:

- aplikimi i referohet disa aktiviteteve/ndërrhyrjeve siç paraqiten në Tabelën 1, ose
- Vlera totale e aplikimeve të pranueshme në kuadër të kësaj thirrje nuk do të rëndojë si shpenzim indirekt burimet financiare të disponueshme.

Në rast se vlera totale e aplikimeve të pranueshme në kuadër të kësaj thirrje do të rëndojë si shpenzim indirekt burimet financiare të disponueshme, atëherë opsioni alternativ do të jetë «Opsioni 1» më sipër.

Përfituesi duhet të paraqesë Kërkesën për Pagesë tek AK në përputhje me modelin e dhënë si shtojcë në kontratë.

Zarfi i jashtëm i Kërkesës për Pagesë duhet të përmbajë::

- referencën: «Fishing Blue - Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri» - Kërkesë për Pagesë, dhe
- emrin e plotë dhe adresën (kontaktet) e Përfituesit, dhe
- numrin e referencës së grantit.

Kërkesa për Pagesë do të përmbajë:

- a) Kërkesën për Pagesë, e cila mund të shkarkohet nga [www.fishingblue.eu](http://www.fishingblue.eu);
- b) të gjitha kopjet e faturave për çdo shpenzim dhe kopjet e pagesave bankare për furnitorët e mallrave dhe/ose shërbimeve;
- c) në Kërkesën për Pagesë të gjitha kostot duhet të shënohen në EURO dhe/ose Lekë; fatura me kosto të shprehur në Lekë do të konvertohet nga përfituesi në EURO bazuar në kursin e këmbimit të deklaruar nga INFOREURO të muajit kur është kryer pagesa(t) për furnizuesin(it); (kursi i këmbimit i INFOREURO gjendet në adresën e mëposhtme: [https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/how-eu-funding-works/information-contractors-and-beneficiaries/exchange-rate-infoeuro\\_en](https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/how-eu-funding-works/information-contractors-and-beneficiaries/exchange-rate-infoeuro_en));
- d) faturat e furnitorëve të huaj, mundësisht, duhet të lëshohen në anglisht; nëse jo, ato do të shoqërohen nga përkthimi në gjuhën angleze, duke deklaruar se janë në përputhje me origjinalin nën përgjegjësinë e Përfituesit të Grantit; në këtë rast, llogaritja e kostos nga valuta e huaj në EURO bazohet në kursin e këmbimit të deklaruar nga INFOREURO në muajin kur është kryer pagesa(t) për furnizuesin(it);
- e) shuma(t) e faturave duhet të pasqyrojnë mallrat dhe kostot përkatëse të përfshira në kontratën e nënshkruar me AK;

- f) kostot e pranueshme dhe faturat mbështetëse duhet të plotësohen në periudhën nga nënshkrimi i Kontratës së Grantit deri në datën e zbatimit të dhënë në kontratë. Çdo kosto e bërë jashtë kësaj periudhe do të konsiderohet jo e pranueshme në Skemën e Granteve.

### **6.8 Kontrollet Ex-Post (përfundimtare)**

Pas marrjes së Kërkesës për Pagesë dhe para ekzekutimit të pagesës përfundimtare të Grantit, AK, përmes një vizite në terren, do të verifikojë nëse përfituesi i grantit e ka kryer investimin në përputhje me specifikimet teknike të përfshira në kontratë. Nëse gjetjet nga vizita në terren do të konfirmojnë që investimi është kryer siç duhet dhe në përputhje me kontratën, AK do të vijojë me pagesën.

Përkundrazi, nëse vizita në terren do të verifikojë që ndërhyrja nuk është kryer, është kryer pjesërisht, ose është kryer në një mënyrë që nuk është në përputhje me kontratën, AK mund të blloktojë pagesën përfundimtare derisa investimi të bëhet në mënyrë korrekte, ose të vendosë të mos paguajë.

Për më tepër, kontrollet ex-post (përfundimtare) mund të kryhen edhe nga MBZHR, Delegacioni i BE-së dhe kontrollorë të tjerë të BE-së, përfshirë Gjykatën Evropiane të Audituesve.

Kontrolli ex-post do t'i njoftohet përfituesit të paktën 5 ditë para inspektimit.

Njoftimi do të menaxhohet nga struktura e ngarkuar për të bërë inspektimin, ndërkohë që përfituesi, së bashku me aplikimin për këtë grant, pranon edhe të ndjekë udhëzimet e marra për inspektim.

### **6.9 Ekzekutimi i Pagesave të Grantit**

Kërkesa e aprovuar do të paguhet në llogarinë bankare të përfituesit të grantit brenda 45 ditëve nga data e dorëzimit.

### **6.10 Marrëveshje mbi Vizibilitetin**

Të gjitha mjetet lundruese që do të mbështeten Kontrata e Grantit duhet të respektojnë Udhëzimet e BE-së për Komunikimin dhe Vizibilitetin.

AK-ja do të pajisë çdo përfitues granti me materialet e nevojshëm vizualë (d.m.th. etiketat) dhe përfituesi duhet të garantojë pozicionimin e këtyre materialeve në mjetet lundruese dhe të sigurojë ruajtjen e tyre për një periudhë 5-vjeçare. Përfituesi është i detyruar të mbajë këto materiale vizualë për 5 vitet e ardhshme pas marrjes së pagesës; MBZHR do të jetë përgjegjëse për respektimin e një detyrimi të tillë.

### **6.11 Bordi i Arbitrazhit**

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes palëve në varësi të interpretimit dhe/ose ekzekutimit të këtyre Udhëzimeve, palët do të përpiqen ta zgjidhin miqësisht mosmarrëveshjen. Nëse kjo nuk do të arrihet, mosmarrëveshja do të gjykohet nga një Bord Arbitrazhi sipas Procedurës dhe Udhëzuesit Praktik të BE (PRAG). Bordi i Arbitrazhit do të përbëhet nga tre anëtarë, dy prej të cilëve caktohen nga një prej secilës palë dhe i treti me marrëveshje të ndërsjellë mes palëve. Çdo vendim i marrë nga Bordi i Arbitrazhit do të jetë i paapelueshëm (i formës së prerë).

## **7 Lista e Shtojcave**

SHTOJCA A: FORMULARI I APLIKIMIT PËR GRANT

SHTOJCA B: SHPENZIMI MAKSIMAL I PËRANUESHËM DHE KONTRIBUTI PUBLIK PËR ÇFARËDOLLOJ  
FUQIE MOTORIKE (kW)

SHTOJCA C: DEKLARATA E NDERIT

SHTOJCA D: PAKETA E DRAFT KONTRATËS